



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj – Sheremeti dhe Franciska Zhitija – Ymeri, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.P “Ardi Tours” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1723/17 të datës 23.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit N.T.P “Ardi Tours” me seli në Prishtinë, e datës 17.04.2020, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1723/17 të datës 23.01.2020, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, N.T.P “Ardi Tours” me seli në Prishtinë, ndërsa ka mbet në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës, nr.07.3/1420/2014 i datës 14.09.2017.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; të aplikimit të gabuar të dispozitave materiale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e ushtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1723/17 të datës 23.01.2020. Të anulohet si i pa bazuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1723/17 të datës 23.01.2020 sipas të cilit aktgjykim është refuzuar në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është lënë në fuqi aktvendimi i Doganës së Kosovës nr.07.3/1420/2014 i datës 14.09.2017.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-122, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës nr.07.3/1420/2014 i datës 14.09.2017, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë N.T.P “Ardi Tours” Fushë Kosovë për rishqyrtimin e aktvendimit 1420 e datës 11.11.2014 I lëshuar nga Drejtoria Rajonale Prishtinë-Njësi I PAKD-së.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në Gjykatën Themelore, e cila pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 23.01.2020 të mbajtur në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditurës e në mungesë të përfaqësuesit të palës paditëse, si në vështrim të nenit 41 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, dhe lënë në fuqi aktvendimin nr.07.3/1420/2014 i datës 14.09.2017. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se; Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton se në procedurën administrative gjendja faktike është vërtetuar drejtë kur është nxjerr konkluzioni se paditësi nuk ka paraqit për zhdoganim mallin lëndor “patika sportive” 16 npr, me anë të Deklaratës Unike Doganore R-30200/21.08.2014. kjo gjendje faktike është vërtetuar nga zyrtarët doganor të shiqimit të cilët pas ekzaminimit të dërgesës së mallit kanë hasur në parregullsi të mallit të deklaruar. Në aktvendimin nr. 1420 të datës 11.11.2014 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Doganore në Prishtinë. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se janë dhënë informata të mjaftueshme të përshkrimit të rastit sa i përket mënyrës dhe vendit të kryerjes së kundërvajtjes doganore, dhe lloji i mallit lëndor nuk është deklaruar në mënyrë të saktë. Gjykata nuk ka gjetur dëshmi për të vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga gjendja e konstatuar nga organi administrativ e paditura e cila e ka bërë ekzaminimin e mallit me rastin e zhdoganimit të mallit. nuk ka gjetur prova se paditësi ka paraqit kërkesë tek zyra doganore për marrje të mostrave të mallrave kontestuese, ku Sektori i Vlerës apo i Tarifës do të jepte mendimin profesional lidhur me kontestimin e deklarimit të llojit të mallit lëndor, dhe do të sqarohet se a kemi të bëjmë me mall të deklaruar apo jo, pastaj gjykata e shkallës së parë e ka pas të pa mundur të nxjerr një konkluzion tjetër nga gjendja faktike e konstatuar gjatë ekzaminimit të mallit doganor. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se paditësi nuk ka paraqitur dëshmi se në cilin emërtim të Deklaratës Doganore e ka paraqitur mallin kontestues apo ka paraqit të njejtin lloj të mallit doganor për tu aplikuar drejtë dispozita ligjore nga nenit 276 pika k) e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës 03/L-109, pastaj gjykata ka konstatuar se në këtë rast nuk ka shkelje të procedurave doganore, dhe se e paditura ka aplikuar drejtë dispozitat e nenit 276 pika a) dhe k) të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës 03/L-109, kur ka bërë përgjegjës paditësin për mos paraqitje të mallit lëndor kontestues, nga ku ka rezultuar me pagesën e borxhit doganor në vlerë më të vogël nga vlera dhe gjendja që paditësi e ka deklaruar mallin me Deklaratën Unike Doganore R-30200/21.08.2014.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. aktgjykimi ankimor nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve në ankesë, dhe as me shkelje qenësore dhe të tjera të dispozitave të LKA, LPA

dhe të Kodit Doganor dhe të Akcizave, të cilat kolegji i heton sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe neni 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-aktvendimit të atakuar nga paditësi, si në vështrim të nenit 81G të Ligjit 04/L-102, me të cilin në procedurë administrative, e gjithashtu sipas aktgjykimit ankimor edhe në procedurë gjyqësore, në mënyrë të plotë është vërtetuar vepra e cila i ngarkohet subjektit se ka kryer kundërvajtjen doganore nga neni 276 paragrafi (a) dhe (k) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës për të cilën është shpallur përgjegjës për mos paraqitje të mallit lëndor kontestues. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim, sipas provave të administruara dhe shkresave të lëndës, ku janë dhënë arsye të justifikueshme të cilat edhe kolegji i pranon, se padyshim është vërtetuar, se paditësi ka kryer kundërvajtje doganore duke mos e paraqitur mallin: patika sportive për të rritur me origjinë nga Turqia, në sasi prej 16 palë, në vlerë prej 128.00€, si dhe ka bërë deklarin të pasaktë të llojit të mallit në emërtimin e 21 dhe 23 të Deklaratës Unike Doganore me nr. 30200/21.08.2014, ku diferenca është në vlerë prej 960€ kurse shmangia nga taksa prej 329€, dhe në këtë mënyrë ka vepruar me qëllim që të paguaj taksa doganore në vlerë më të ulët se nga ajo realja. Andaj, me veprimin e tij ka kryer kundërvajtje doganore si parashihet në nenit 276 pika a) dhe k), të Kodit Doganor dhe të Akcizave, dhe për këtë kundërvajtje është gjorbitur nga organet doganore si në aktvendimin e saj të cekura si më lartë.

Kolegji, shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera të cekura si më lartë dhe në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtin e refuzon si të pa bazuara, dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse nuk dëshmohet se gabimisht është aplikuar e drejta materiale e po ashtu gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në mënyrë të plotë në gjykatën e shkallës së parë dhe në organin përfundimtar të Doganës së Kosovës, sepse në Zyrën e Brendshme Doganore në Prishtinë kontrollës doganore nuk i ka paraqitur mallin: patika sportive për të rritur me origjinë nga Turqia, në sasi prej 16 palë, në vlerë prej 128.00€, si dhe ka bërë deklarin të pasaktë të llojit të mallit në emërtimin e 21 dhe 23 të Deklaratës Unike Doganore me nr. 30200/21.08.2014, me qëllim që të paguaj taksat doganore në vlerë më të vogël, andaj me të drejtë nga organi i paditur është vlerësuar se paditësi ka kryer kundërvajtje doganore, ku në bazë të rrethanave për shkak të mos deklarimit të mallit kontrollës doganore, janë formësuar të gjitha tiparet esenciale të kundërvajtjes doganore nga neni 276 pika a) dhe k) KDAsë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe

kjo gjykatë, andaj, ankesat, e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES

Dhomat e Shkalles se Dytë

K.DH.SH.II.nr.98/22, me datë 05.12.2023

**Kryetar i kolegjit - Gjyqtari,
Faton Bajrami**